

## **STATUTI I SUBJEKTIT TREGTAR “MBRETËRESHA E LIGJIT” SH.P.K**

Në bazë të ligjit nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë së Republikës së Shqipërisë, Kodit Etik të Avokatit, ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, ligjit nr. 9723 dt. 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, ligjit nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, unë e nënshkruara:

- ❖ ENIDA KAZIU, e bija e Merfasë dhe e Agimit, lindur më 17.01.1988 në Durrës dhe banuese në adresën: Lagjja Nr. 4, Nd.2, H.4, Rruga “Iljaz Reka”, Durrës, shtetase shqiptare, identifikuar me letërnjoftimin me nr. Personal I85117056N, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, liçencuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë së Republikës së Shqipërisë, me liçencë Nr. 12099 për ushtrimin e profesionit të avokatit, anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë dhe ushtruese aktive e profesionit, në cilësinë e administratorit dhe ortakut të vetëm, sot më datë 15.09.2023, miratoj statutin e subjektit tregtar “MBRETËRESHA E LIGJIT”SH.P.K, me përmbajtje si vijon:

### **NENI 1**

#### **FORMIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

Administrator dhe ortak I vetëm i subjektit tregtar “MBRETËRESHA E LIGJIT”-SH.P.K, është vetëm shtetësja:

ENIDA KAZIU, e bija e Merfasë dhe e Agimit, lindur më 17.01.1988 në Durrës dhe banuese në adresën: Lagjja Nr. 4, Nd.2, H.4, Rruga “Iljaz Reka”, Durrës, shtetase shqiptare, identifikuar me letërnjoftimin me nr. Personal I85117056N, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, liçencuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë së Republikës së Shqipërisë, me liçencë Nr. 12099 për ushtrimin e profesionit të avokatit, anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë.

### **NENI 2**

#### **EMËRTIMI TREGTAR**

Emërtimi tregtar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “MBRETËRESHA E LIGJIT”.

### **NENI 3**

#### **SELIA E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

Selia e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është në adresën: Njësia administrative Nr.10, Rruga “Myslym Shyri”, Pallati Nr.15, Hyrja Nr.1,Kati i dyte, Apartamenti Nr.7, Tiranë.



#### NENI 4

### KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është e pakufizuar.

#### NENI 5

### OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, bazuar në ligjin nr.55/2018 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", konsiston si më poshtë vijon:

- Ofrimi i shërbimeve avokatore,
- Këshillim ligjor për individët, personat fizikë (tregtarët) dhe personat juridikë, vendas dhe të huaj, në çdo fushë të së drejtës,
- Përfaqësim në procesin penal, civil, administrativ, tregtar dhe çdo fushë tjetër të së drejtës, në çdo shkallë të gjyqësorit,
- Përfaqësim pranë organeve të procedimit penal, pranë organeve të tjera shtetërore dhe administratës publike, pranë personave juridikë publikë e privatë, vendas dhe të huaj, pranë gjykatave ndërkombëtare, pranë çdo organizmi tjetër ndërkombëtar në të cilin Republika e Shqipërisë ka aderuar,
- Hartimi i akteve juridike sipas kërkesave të individëve, personave fizikë (tregtarëve) dhe personave juridikë, vendas dhe të huaj,
- Kryerja e çdo veprimi dhe çdo lloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji për ushtrimin e profesionit të avokatit,
- Bashkëpunimi me avokatë, zyra avokatie apo çdo lloj forme tjetër organizimi avokator, brenda apo jashtë vendit.

#### NENI 6

### SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar merr masat e nevojshme për sigurimin e përgjegjësisë profesionale, sipas rregullave të përcaktuara në Statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë së Republikës së Shqipërisë.



## NENI 7

### NDRYSHIME NË TË DHËNAT E REGJISTRIMIT

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të ndryshojë emërtimin e vet, selinë, objektin e aktivitetit në përputhje me lejetimet e legjislacionit shqiptar në fuqi në momentet që do diktohen rrethana për ndryshime.

## NENI 8

### KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Kapitali themeltar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, përbëhet nga 1 kuotë (pjesë), me vlerë 100 (njëqind) lekë. Kapitali themeltar është 100 % kontribut i ortakut të vetëm. Kontributi i nënshkruar i kapitalit nuk është paguar.

## NENI 9

### MARRËDHËNIET E PUNËS

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të drejtat e punëmarrësit, ndërsa të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin dhe rregulloren e brendshme të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj të fundit, nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

## NENI 10

### KONFIDENCIALITETI

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e të gjitha informacioneve, akteve dhe dokumenteve që janë siguruar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

## NENI 11

### BILANCI DHE FITIMET

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, do të mbyllet më datë 31 Dhjetor të çdo viti.

## NENI 12

### LIBRAT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

12.1 Regjistri i shërbimeve dhe veprimeve të avokatisë, krijohet dhe administrohet në përputhje me formën dhe përmbajtjen e përcaktuar në Statutin e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë.



12.2 Librat tregtarë dhe profesionalë duhet të ruhen për një periudhë 10 vjeçare, e çdo faqe duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur.

### NENI 13

#### Ç'REGJISTRIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Në rast se shoqëria me përgjegjësi të kufizuar vendos të mbyllë aktivitetin tregtar, për ç'regjistrimin e vet nga Qendra Kombëtare e Biznesit do të merret administratori dhe ortaku i vetëm, me dokumentet dhe procedurat përkatëse, sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit tregtar në fuqi.

### NENI 14

#### DISPOZITË E FUNDIT

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, gjejnë zbatim dispozitat e ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, ligjit nr. 55/2018 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", Statutit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë së Shqipërisë dhe Kodit Etik të Avokatit. Çdo ndryshim i dispozitave të këtij statuti bëhet në të njëjtën mënyrë siç është miratuar ky Statut.

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "SH.P.K", përfaqësuar nga:

AVOKATE ENIDA KAZIU

